Në bazë të nenit 46, 47, 48 dhe 49 nga Ligjit për përdorimin dhe shfrytëzimin e gjërave në pronësi të shtetit dhe në pronësi të komunës ("Gazeta Zyrtare" të Republikës së Maqedonisë nr.78/15, 106/15, 153/15, 190/16, 21/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut'' nr. 101/19, 275/19 dhe 122/21), në pajtim me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.41-9576/6 të datës 25.11.2022, të publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.216/22, Komisioni për shitjen e gjërave të luajtshme të Republikës së Maqedonisë së Veriut , shfrytëzues Arkivi Shtetëror i Republikës së Maqedonisë së Veriut, jep në vijim:

SH P A LL J E nr. 1/2026

për shitjen e parë të gjërave të luajtshme - mjet motorik për udhëtim në anë të ankandit publik elektronik

I. LËNDA PËR SHITJEN, ÇMIMI FILLESTAR, SHUMA E GARANCISË BANKARE DHE DATA E ANKANDIT PUBLIKE:

1. Lënda për shitje

Lëndë për shitjen të gjërave të luajtshme - për hekurishte të vjetra, pronë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, shfrytëzues i të cilave është Arkivi Shtetëror i Republikës së Maqedonisë të Veriut, në pajtim me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për shitjen e gjërave të luajtshme nr. 57/4652/4 nga viti 03.06.2026 e publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 261/26 edhe atë:

1. Mjeti motorik për udhëtim: marka Renault Laguna, numër regjistrimi SK 0615 AC, numër shasie VF1B56J0519609622, numër motori C055326, viti i prodhimit 1999, fuqia e motorit 72 KW, vëllimi i motorit 1870 cm3, ngjyra e karrocerisë metalikë kafe /8D, me vlerë të përllogaritur në 14.148,00 denarë pa TVSH, vlerësimi numër CB/EL V-41/25-7 nga viti 17.12.2025 dhe

Mjete gjenden në oborrin e Arkivit Shtetëror - Njësia Shkup, në rr.Mososvska nr.1 Shkup.

Informata më të hollësishme mund të jepen në nr. e tel. 070/447-179.

Ankandi publik për mjetin motorik për udhëtim, Renault Laguna, do të realizohet në mënyrë elektronike në ankandin publik me datë 24.11.2026, me fillim në ora 12:00.

2. Çmimi fillestar i automjeteve dhe shuma e garancisë bankare

Shitja e çdo mjet motorik për udhëtim do të kryhet në mënyrë veçmas me anë të ankandit publik elektronik përmes sistemit elektronik të ankandit publik me të cilën menaxhohet dhe operohet nga Ministria e Financave - Administrata e çështjeve pronësore-Juridike me vlerë të parashikuar sipas Vlerësimit të Byrosë së ekspertizës ligjore nr. CB/EL

V-41/25-7 nga 17.12.2025 viti në të cilin vlera e automjetit është vlerësuar është 14.148,00 denarë pa TVSH

Çmimi fillestar i ankandit publik elektronik është çmim fillestar sipas vlerës së parashikuar dhe përcaktuar në Vlerësimin numër CB/EL V-41/25-7nga 17.12.2025 nga Byroja e ekspertizës ligjore.

Shuma e garancisë bankare për seriozitetin e ofertës për mjetin motorik për udhëtim marka Renault Laguna është 2% nga shuma e çmimit fillestar i ankandit publik elektronik, përkatësisht shuma e garancisë është 282 denarë.

II. TË DREJTË PËR PJESËMARRJE

Të drejtën e pjesëmarrjes në ankandin publik elektronik kanë të gjithë personat fizikë dhe juridikë vendas dhe të huaj, të cilët mund të fitojnë pronësinë e gjërave të luajtshme - mjeteve motorike të udhëtimit.

Shuma fillestare e ankandit publik për mjetin motorik të udhëtimit Renaultl Laguna është 14.148,00 denarë

III. DOKUMENTET E DUHURA PËR PJESËMARRJE NË ANKANDIN PUBLIK

Regjistrimi për pjesëmarrje në ankandin publik bëhet në mënyrë elektronike në ueb faqen: www.e-aukcii.finance.gov.mk

Në shtesë, aplikuesi duhet të paraqesë:

1. Garanci bankare për seriozitetin e ofertës në vlerë prej 2% nga çmimi fillestar i ankandit publik, gjegjësisht shuma e garancisë për veturën Renault Laguna është 282 denarë Garancia bankare dorëzohet në mënyrë elektronike dhe me shkrim në origjinal në arkiv në zarf të mbyllur me shënimin "Komisioni për shitjen e sendeve të luajtshme – mjeteve motorike të udhëtimit", në adresën Dimitar Vlahov nr. 19 Shkup.

A) për personat juridikë

1.Gjendja aktuale nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut, gjegjësisht dokument përkatës i lëshuar nga organi kompetent nga shteti ku personi juridik është i regjistruar.

B) për personat fizikë

2. Kopje e kartës së identitetit ose dokumentit të udhëtimit.

IV. AFATI I REGJISTRIMIT

Për të marrë pjesë në ankandin publik, pjesëmarrësit janë të detyruar të regjistrohen në mënyrë elektronike deri në fund të ditës së 11-të, e llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes në gazetat ditore dhe në faqen e internetit, përkatësisht deri më 23.11.2026.

Komisioni do t'u japë një emër përdoruesi dhe kod për pjesëmarrje në ankand publik për aplikuesit që kanë aplikuar në sistemin elektronik të tenderit publik me një sërë dokumentesh të bashkëngjitura, në afat të 3 ditëve nga skadimi i kohëzgjatjes së shpalljes, si dhe aplikuesit që kanë aplikuar me dokumentacion të paplotësuar u dërgohet njoftim se nuk do të kenë mundësi të marrin pjesë në ankandin publik.

V. MËNYRA DHE PROCEDURA PËR ZBATIMIN E ANKANDIT PUBLIK

Ankandi publik zbatohet në pajtim me dispozitat e nenit 26 të Ligjit për përdorimin dhe shfrytëzimin e gjërave në pronësi të shtetit dhe në pronësi të komunës ("Gazeta Zyrtare" të Republikës së Maqedonisë nr.78/15, 106/15, 153/15, 190/16, 21/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 101/19, 275/19, 122/21 dhe 193/23).

Për t'u realizuar ankandi publik është e nevojshme të ketë të paktën një pjesëmarrës. Blerësi më i favorshëm në ankandin publik llogaritet pjesëmarrësi i cili ka ofruar çmimin e fundit, që përfaqëson çmimin më të lartë për shitjen e gjërave të luajtshme.

Blerësi më i favorshëm është i detyruar në afat të 15 ditëve nga marrja e njoftimit me shkrim të përzgjedhjes të paguajë mjetet në pajtim me çmimin përfundimtar të ankandit, në të kundërtën nuk do të lidhet asnjë kontratë ndërsa garancia bankare për seriozitet të ofertës do të aktivizohet ku dhe blerësi për një periudhë 1 vjeçare nuk do të mund të marrë pjesë në asnjë ankand publik të ardhshëm për gjërat e luajtshëm në fjalë.

Kontrata e shitjes do të lidhet me blerësin më të favorshëm në afat të 15 ditëve të punës pas pagesës së kryer të çmimit për gjërat e luajtshme - mjet motorik për udhëtim. Të gjitha shpenzimet (taksa, vërtetimet, etj.) që do të dalin në lidhje me kalimin e pronësisë së automjeteve do ti marrë përsipër blerësi - blerësi më i favorshëm.

Pjesëmarrësit në ankandin publik kanë të drejtë ankese vetëm në lidhje me procedurën e ankandit publik. Ankesa paraqitet deri te Komisioni në afat të 3 ditëve nga dita e mbajtjes së ankandit publik. Komisioni vendos pas ankesës me vendim në afat të 5 ditëve nga marrja e ankesës. Kundër vendimit të Komisionit mund të bëhet ankesë në Komisionin shtetëror për vendimmarrje në procedurë administrative dhe në marrëdhënie pune të shkallës së dytë.

VI. FAQJA E INTERNETIT NE TË CILËN DO TË PUBLIKOHET ANKANDI PUBLIK

Ankandi publik do të kryhet në mënyrë elektronike në faqen në vijim të internetit:
www.e-aukcii.finance.gov.mk

Ankandi publik për mjetin motorik për udhëtim, Renault Laguna do të realizohet në mënyrë elektronike në ankandin publik me datë 24.11.2026, me fillim në ora 12:00.

Komisioni për shitjen e sendeve së luajtshme të
Arkivit Shtetëror të Republikës Maqedonisë së Veriut